



VENDIM

Nr. 45 Datë 12.04.2016

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË “EVN TRADING” SH.P.K, PËR
HEQJEN E LICENSËS PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 179 SERIA T12, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 124, DATË 29.08.2012 TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE**

Në mbështetje të neneve 16; 39 pika 1 dhe 42 pika 1 gërma “dh” të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 121/1 të ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 5.1 gërma “a” të Liçencës për Tregtim T12; nenit 5 të Rregullores për Proçedurat e Heqjes së Liçensave, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.04.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve për heqjen e liçensës së shoqërisë “EVN TRADING” sh.p.k, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 179 Serie T12, miratuar me vendimin nr. 124, datë 29.08.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE,

Konstatohet se :

- Shoqëria “EVN TRADING” sh.p.k, me shkresën nr. 28 Prot, datë 06.01.2016, ka paraqitur në ERE një kërkesë për heqjen e liçensës për aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, me nr. 179, seri T12, miratuar me vendimi te Bordit te ERE-s nr. 124, datë 29.08.2012.
- Me vendimin nr. 14, datë 16.02.2016, ERE vendosi fillimin e proçedurave për heqjen e liçencës me nr. 179 dhe numër Serie T12 të shoqërisë “EVN TRADING” sh.p.k,
- Shoqëria “EVN TRADING” sh.p.k ka shlyer çdo detyrim financiar ndaj ERE siç parashikuar në kushtet e liçensës;
- Shoqëria “EVN TRADING” sh.p.k nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitetin për të cilin është licensuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “EVN TRADING” sh.p.k, për heqjen e liçencës me nr. 179 dhe numër Serie T12.
2. Shfuqizimin e Vendimit Nr. 124, datë 29.08.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “EVN TRADING” sh.p.k për Vendimin e Bordit të ERE-s dhe Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 45 Datë 12.04.2016

**MBI
MIRATIMIN E KËRKESËS SË “EVN TRADING” SH.P.K, PËR
HEQJEN E LICENSËS PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 179 SERIA T12 ,MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 124, DATË 29.08.2012 TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____